



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 282/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazic dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Malishevë paraqitur kundër Iniciativës Qytetare të Malishevës (IQM), dega në Malishevë, për shkak të pa rregullsive gjatë mbajtjes së tubimit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Arsyetim

Me datën 18.10.2013, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se Iniciativës Qytetare të Malishevës (IQM) më datë 17.10.2013 në orën 19:30 ka penguar mbarëvajtjen e tubimit zgjedhor të PDK-së në fshatin Bardh-Malishevë, duke sulmuar aktivist të PDK-së dhe tentuar për të djegur flamurin e këtij subjekti, me të cilin veprim sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e Rregullave Zgjedhore dhe LZP-së.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik IQF, me datën 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013 deri në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik IQF, lidhur me ankesën A.nr 282/2, të paraqitur nga subjekti politik PDK, ku theksohet se akuzat nga ana e PDK-së janë të pavërteta sepse nuk kemi të bëjmë asgjë me këto veprime të bëra Ne, siç thonë ata menjëherë pasi që jemi informuar për ngjarjen kemi kontaktuar me disa persona që kanë qenë prezent dhe kemi kuptuar se është arrestuar nga policia një person.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore nga subjekti politik PDK nuk qëndrojnë ngase nuk janë mbështetur me asnjë dëshmi të cilat do të ndikonin në marrjen e vendimit, prandaj pretendimet e tilla u vlerësuan si të pabazuara andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 282/2013 më datën 25.10.2013.

Kryesuesi i Panelit

Nehat Idrizi

Prishtinë / Pristina

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.

